



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U “Nënë Tereza” kërkon të punësojë punësojë **1 (një) Specialist në Sektorin e Planifikimit Buxhetor dhe Projekteve në Drejtorinë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Arsim i Lartë në profilin Ekonomik. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi,*
- Njohuri shumë të mira të kuadrit ligjor për planifikimin buxhetor, njohje të procedurave për hartimin e projekt-buxhetit, detajimin e tij si dhe ndjekjen dhe realizimin e buxhetit vjetor të institucionit,
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara,
- Të ketë njohuri të programeve kompjuterike financiare,
- Aftësi shumë të mira komunikimi.
- Aftësi për të punuar në grup.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë në gjuhën shqipe, dokumentat e mëposhtëm:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV)
3. Diplomën/at e arsimit të lartë të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Formulari i vetedeklarimit të gjendjes gjyqësore (<http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU “Nënë Tereza” duke nisur nga data **07.12.2022 ora 08:00 deri më 21.12.2022 ora 16:30.**

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE